



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot.

Krujë, më 02.09.2026

Shtojca 13.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

[Data 02.09.2026]

Drejtuar: [B.O.E “**MAKARESH**” sh.p.k, me adresë Durrës Fushë- Krujë , Lagjja Grumbullimit, rruga e Laçit, pallat i ri, kati 1, zona kadastrale nr. 1664, me numër pasurie 3/426, me NIPT K24725213C, me administrator Z.Qamil Babasi përqindja në pjesëmarrje 10.6% dhe “**LIQENI VII**” sh.p.k me adresë Lagja 14 Rruga “Dituria”,Shkozet, Durres, 2007 me NIPT K01730502W dhe administrator z. Musa Kalia, përqindja në pjesëmarrje 89.4%, perfaqesues i BOE subjekti “**MAKARESH**” sh.p.k]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

- **Tipi i Kontratës: “Pune publike”**
- **Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedure e Hapur “**
- **Numri i referencës së procedurës /Lotit : REF-85710-05-14-2026.**
- **Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër:“Rikualifikim urban i qendrës së qytetit Fushë Krujë (Faza I)”.**

- **Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):** Pune Ndertimi / (45000000-7).
- **Fondi limit: 105'801'582 (njqind e pese milion e teteqind e nje mije e peseqind e tetedhjte e dy) lekë pa t.v.sh,** vënë në dispozicion nga të Ardhurat e Bashkisë Krujë.
- Vlera e likudimit per ***vitin ushtrimor 2026*** eshte 5'186'058 (*pesembedhjte milion e treqind e tetedhjte e pese mije e shtateqind e njezet*) leke pa t.v.sh dhe 18'462'864(*tetembedhjte milion e katerqind e gjashtedhjte e dy mije e teteqind e gjashtedhjte e kater*) leke me t.v.sh, ***per vitin ushtrimor 2027*** vlera e likudimit do te jete ne shumen prej 57'374'877(*pesedhjte e shtate milion e treqind e shtatedhjte e kater mije e teteqind e shatedhjte e shtate*) leke pa t.v.sh dhe 68'849'852(*gjashtedhjte e tete milion e teteqind e dyzet e nente mije e teteqind e pesedhjet e dy*) leke me t.v.sh, ***per vitin ushtrimor 2028*** vlera e likuidimit do te jete ne shumen 33'040'986(*tridhjte e tre milion e dyzet e mije e nenteqind e tetedhjte e gjashte*) leke pa t.v.sh dhe 39'649'183(*tridhjte e nente milion e gjashteqind e dyzet e nente mije e njeqind e tetedhjte e tre*) leke me t.v.sh .
- **Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj :06(gjashte) muaj** nga data e fillimit te punimeve.
- **Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 15.05.2026**
- **Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike:** Buletini Nr. 32 datë 18 MAJ 2026
- Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 20.08.2026
- ¹Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit [Data] [Numri] Buletini Nr. 54 datë 24 Gusht 2026.
- Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:
 - oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐
 - oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **B.O.E “M U R A T I” sh.p.k,** me adresë Dibër, BULQIZE, Rruga Ish Këshilli i Rrethit Bulqizë, Lagjja e re, Banesa 775/1, Shkalla 1, Kati 4, Apartamenti 1 , me NIPT J66702413V dhe administrator z. Eugent Murati përqindja në pjesëmarrje 13.66 % dhe **“SELAMI” sh.p.k** me adresë Pranë Hotel “Veri”, Peshkopi, 8301 me NIPT

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

J77304706L dhe administrator z. Musa Selami përqindja në pjesëmarrje 86.34%, perfaqesues i BOE subjekti **“M U R A T I” sh.p.k.**

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 84 339 753 (tetëdhjet e katër milion e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa t.v.sh.

2. **“COMPANY RIVIERA 2008” sh.p.k.**, me adresë Kamëz, Rruga Nacionale Kamëz-Fushë Krujë, Kthesa e Valiasit Nr.1; 1030, me NIPT K81716011V dhe administrator z.Agim Kola.

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 72 257 364 (shtatëdhjetë e dy milion dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa t.v.sh .

3. **“K.M.K” sh.p.k.**, me adresë Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090 1057 me NIPT L78223801E dhe administrator z. Kelmend Caushaj dhe subjekt mbështetës **“Caushi M” sh.p.k** Fier Ballsh BALLSH Ballsh-Mallakastër, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati I-re, Zona Kadastrale 1090, Nr Pasurie 7/9810 me NIPT L88419801O, me administrator z. Mehmet Caushaj.

- **Vlera e ofertës ekonomike**=78 983 284(shtatëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër)lekë pa t.v.sh.

4. **“K.TURJA” sh.p.k.**, me adresë pranë Urës së Gjolës,Bubq Budull 1505 me NIPT K81314014A dhe administrator z.Genci Truja dhe subjekt mbështetës **“Almo Konstruksion” sh.p.k** , me adresë Zall-Mner i ri, rruga nacionale Kamëz, Tiranë, me NIPT J91915001P dhe administrator z.Alfons Bitri perfaqesues i BOE subjekti **“K.TURJA” sh.p.k.**

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 85 272 258 (tetëdhjetë e pesë milion e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa t.v.sh .

5. **B.O.E “KEGLI-DURI ” sh.p.k.**, me adresë Durrës Fushë- Krujë , Lagjja Grumbullimit, rruga e Laçit, pallat i ri, kati 1, zona kadastrale nr. 1664, me numër pasurie 3/426, me NIPT K94016202U , me administrator Z.Durim Babasi përqindja në pjesëmarrje 40.2 % dhe **“VARAKU E” sh.p.k.**, me adresë Durres Shijak Qarku Durres, Bashkia Shijak,Njesia Administrative Shijak Fshati Sallmone, Godinë private, ZonaKadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30, me NIPT J61902509S dhe administrator z. Shpetim Varaku, përqindja në pjesëmarrje 59.8%, perfaqesues i BOE subjekti **“KEGLI-DURI ” sh.p.k.**

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 63 050 163 (gjashtëdhjetë e tre milion e pesëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa t.v.sh .

6. **B.O.E: “MAKARESH” sh.p.k.**, me adresë Durrës Fushë- Krujë , Lagjja Grumbullimit, rruga e Laçit, pallat i ri, kati 1, zona kadastrale nr. 1664, me numër

pasurie 3/426, me NIPT K24725213C, me administrator Z.Qamil Babasi përqindja në pjesëmarrje 10.6% dhe **“LIQENI VII” sh.p.k** me adresë Lagja 14 Rruga “Dituria”, Shkollë, Durrës, 2007 me NIPT K01730502W dhe administrator z. Musa Kalia, përqindja në pjesëmarrje 89.4%, përfaqësues i BOE subjekti **“MAKARESH” sh.p.k.**

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 79 405 121 (shtatëdhjetë e nëntë milion e katërqind e pesë mijë e njëzet e një) lekë pa t.v.sh.

7. **“NDREGJONI” sh.p.k**, me adresë Tirane , Njesia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega , ndërtesa nr. 32, hyrja 8 kodi postar 1017, me NIPT K31329048I dhe me administrator z.Xhetan Ndregjoni.

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 86 772 659 (tetëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa t.v.sh.

8. **“NIKA” sh.p.k**, me adresë Lagja “Vasil Shanto”, Bulevardi “Skenderbeu”, pas Kinema Millenium, Shkollë, Kodi postar 4001 , me NIPT J76705047U dhe administrator zj.Shpresa Nika.

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 70 792 985.62 (shtatëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e dy) lekë pa t.v.sh.

9. **“PE - VLA - KU” sh.p.k**, me adresë Rr.Muzakët, pallati Vokshi k.7 1001 Tiranë , me NIPT K61716013M dhe administrator z.Vladimir Pjetërgjokaj me subjekt mbështetës “PE - VLA - KU” sh.p.k dega Kosovë, me adresë Rr. Tringe Smajli, 16/7 Prishtinë me administrator z.Vladimir Pjetërgjokaj.

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 84 612 254.60 (tetëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë) lekë pa t.v.sh.

10. **“RSM COMPANY” sh.p.k**, me adresë Tirane 1001, me NIPT 810802422 dhe administrator znj.Elida Kola me subjekt mbështetës “AURORA KONSTRUKSION” sh.p.k NIPT K02017003I me adresë Blv“Zogu I”, pallati pranë FSHN, kati 2,Tirane 1001

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 66 618 218 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa t.v.sh.

11. “Shendelli” sh.p.k, me adresë Lagjja "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat Fier 9301, me NIPT K07924803N dhe me administrator z.Yzedin Bozhaj.

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 85 352 907 (tetëdhjetë e pesë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatë) lekë pa t.v.sh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. B.O.E “M U R A T I” sh.p.k, me adresë Dibër, BULQIZE, Rruga Ish Këshilli i Rrethit Bulqizë, Lagjja e re, Banesa 775/1, Shkalla 1, Kati 4, Apartamenti 1 , me NIPT J66702413V dhe administrator z. Eugent Murati përqindja në pjesëmarrje 13.66 % dhe **“SELAMI” sh.p.k** me adresë Pranë Hotel “Veri”, Peshkopi, 8301 me NIPT J77304706L dhe administrator z. Musa Selami përqindja në pjesëmarrje 86.34%, perfaqesues i BOE subjekti **“M U R A T I” sh.p.k.**

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 84 339 753 (tetëdhjet e katër milion e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa t.v.sh.

Përkatësisht për arsyet si vijon :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga B.O.E “MURATI” sh.p.k & “SELAMI” sh.p.k, nga ana e KVO është konstatuar se :

Operatori ekonomik “SELAMI” sh.p.k (anëtar në B.O.E me “M U R A T I” sh.p.k) në kuadër të përmbushjes së kriterit për punë të ngjashme, **nuk ka paraqitur aktin e kolaudimit të kontratës së deklaruar**, sipas kërkesave të pikës 2.3 (ii) të Dokumentave Standard të Tenderit.

Për rrjedhojë, pika 2.3 (ii) e Dokumentave Standard të Tenderit nuk plotësohet dhe kriteri për përvojën e mëparëshme të ngjashme nuk konsiderohet i përmbushur. Oferta nga B.O.E “M U R A T I” sh.p.k & “SELAMI” sh.p.k rezulton e pakualifikueshme dhe skualifikohet.

2. B.O.E “ KEGLI-DURI ” sh.p.k, me adresë Durrës Fushë- Krujë , Lagjja Grumbullimit, rruga e Laçit, pallat i ri, kati 1, zona kadastrale nr. 1664, me numër pasurie 3/426, me NIPT K94016202U , me administrator Z.Durim Babasi përqindja në pjesëmarrje 40.2 % dhe **“VARAKU E” sh.p.k,** me adresë Durres Shijak Qarku Durres, Bashkia Shijak, Njesia Administrative Shijak Fshati Sallmone, Godinë private, Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30, me NIPT J61902509S dhe administrator z. Shpetim Varaku, përqindja në pjesëmarrje 59.8%. perfaqesues i BOE subjekti **“KEGLI-DURI ” sh.p.k.**

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 63 050 163 (gjashtëdhjetë e tre milion e pesëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa t.v.sh .

Përkatësisht për arsyet si vijon :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga B.O.E “KEGLI-DURI” sh.p.k & “VARAKU E” sh.p.k, nga ana e KVO është konstatuar se :

Oferta ekonomike e dorëzuar nga operatori ekonomik B.O.E “KEGLI-DURI” sh.p.k & “VARAKU E” sh.p.k **rezulton të jetë ofertë anomalisht e ulët** , e për pasojë në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 93 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82.4 të VKM n.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, kjo ofertë refuzohet.

Për rrjedhojë, oferta e B.O.E “KEGLI-DURI” sh.p.k & “VARAKU E” sh.p.k skualifikohet.

3. **“RSM COMPANY” sh.p.k** me adresë Tirane 1001, me NIPT 810802422 dhe administrator znj.Elida Kola me subjekt mbështetës “AURORA KONSTRUKSION” sh.p.k NIPT K02017003I me adresë Blv“Zogu I”, pallati prane FSHN, kati 2,Tirane 1001.

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 66 618 218 (gjastëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa t.v.sh.

Përkatësisht për arsyet si vijon :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga Operatori Ekonomik “RSM COMPANY sh.p.k nga ana e KVO është konstatuar se :

Oferta ekonomike e dorëzuar nga operatori ekonomik sh.p.k **rezulton të jetë ofertë anomalisht e ulët** , e për pasojë në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 93 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82.4 të VKM n.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, kjo ofertë refuzohet.

Për rrjedhojë, oferta e “RSM Company sh.p.k skualifikohet.

4. **“NIKA”sh.p.k**, me adresë Lagja “Vasil Shanto”, Bulevardi“Skenderbeu”, pas Kinema Millenium, Shkoder, Kodi postar 4001 , me NIPT J76705047U dhe administrator zj.Shpresa Nika.

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 70 792 985.62 (shtatëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e dy) lekë pa t.v.sh.

Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik **“NIKA”sh.p.k**, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se:

-Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.1.a) të Dokumentave Standarde të Tenderit, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, 1-a)Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2026 te leshuar nga ana e njesive vendore ku operatori ekonomik ka seline si dhe ushtron aktivitet sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2026 per secilin operator).**

Operatori ekonomik **“NIKA”sh.p.k** nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë detyrimet vendore për vitin 2026 për seline ku ushtron aktivitetin (Bashkia Shkoder) si dhe per vendet e tjera ku ushtron aktivitetin sipas te dhenave ne QKB

(Bashkia Tirane, Bashkia Devoll, Bashkia Vau Dejes), sipas kërkesës së përcaktuar në DST. Operatori ka paraqitur vërtetime për vitet 2024 dhe 2025, të cilat nuk plotësojnë kërkesën e autoritetit kontraktor për vitin 2026.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit 2.1.a.

-Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **1.i të Dokumentave Standarde të Tenderit, Kriteret e përgjithëshme- i)** *nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;*

Operatori ekonomik “Nika” sh.p.k nuk ka paraqitur vërtetim nga APP për mos përjashtim nga e drejta për të fituar kontrata publike.

Për rrjedhojë operatori ekonomik nuk ka përmbushur kriterin e përgjithëshëm të kualifikimit 1.i.

-Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3.4 të Dokumentave Standarde të Tenderit, Personeli mbeshtetes i kualifikuar dhe teknik - b)** *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë shofere/drejtues mjeti gjithsej 05(pese) punonjes te drejtimit te automjeteve te profileve te meposhtme:*

-Shoferë kamioni→2 shoferë,

-Shoferë kamioncine→1 shofer

-Shoferë autoboti→1 shofer

-Shoferë kamioni me vinç→1 shofer

Per cdo profil te shofereve te mesiperm nga ana e operatorit ekonomik pjesemarrës duhet te paraqitet si prova apo deshmi te disponimit te tyre dokumentacioni i meposhtem:

- Kontrata individuale punës e vlefshme (pergjate gjithe periudhes se realizimit te kontrates).*
- Leja e Drejtimit per kategorine perkatese sipas kerkesave te rregulloreve ne fuqi te miratuara nga autoritetet kompetent publike (e vlefshme).*
- Dëshmite e aftesise profesionale ose Certificate te Aftesise Profesionale(CAP)(të vlefshme),lëshuar nga institucionet perkatese/autoritetet kompetente sipas rregullave te qarkullimit rrugor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise sipas kategorise respektive te mjetit .*

Operatori ekonomik “NIKA” sh.p.k nuk ka paraqitur Certificate te Aftesise Profesionale(CAP),lëshuar nga institucionet perkatese/autoritetet kompetente sipas rregullave te qarkullimit rrugor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise sipas kategorise respektive te mjetit, për 2 (dy) shoferë, përkatësisht për shoferin e kamionit me initiale B.N dhe shoferin e autobotit me initiale S.K.

Për rrjedhojë, në mungesë të dokumentacionit për dy shoferet, kërkesa e kriterit **2.3.4 nënpika b)** nuk konsiderohet e plotësuar.

-Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3.5 të Dokumentave Standarde të Tenderit, **Dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike, nënpika 3-** *Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).*

Operatori ekonomik “**NIKA**”sh.p.k, për mjetin Autobitumatriçe me targë AKMT79, të marrë me qira me nr.40 datë 29.05.2026 me shoqërinë “Vashtemia” sh.p.k, nuk ka paraqitur çertifikatën për transportin e mallrave të rrezikshëm.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit , **Dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike 2.3.5 nënpika 3.**

-Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3.5 të Dokumentave Standarde të Tenderit, **Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës , nënpika 1 -** *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi duhet të paraqitet a)dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit ne pronesi leja e qarkullimit(e vlefshme) - b)çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme); c)siguracionin e detyrueshem te mjetit sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi (i vlefshëm); d) Çertifikatë transporti mallrash sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi (e vlefshme) , Ndersa per mjete te marra me qira/perdorim krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet/n edhe kontrata/t përkatëse te qerasë/marrjes ne perdorim e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.*

Për mjetin **Grejder** nuk disponohet dokumentacioni tekniko-ligjor i nevojshëm a)dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit ne pronesi leja e qarkullimit(e vlefshme) - b)çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme); c)siguracionin e detyrueshem te mjetit sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi (i vlefshëm); pasi Grejder është mjet i cili duhet të ketë dokumentacionin ligjor të qarkullimit.Operatori ekonomik ka paraqitur vetëm deklaratë doganore me nr.R 19897 datë 21.08.2008.

Për rrjedhojë, në mungesë të dokumentacionit për mjetin Grejder, kërkesa e kriterit **2.3.5 nënpika 1** nuk konsiderohet e plotësuar.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion e vlefshëm sipas kërkesave të nenit 82.5 te Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

- **“COMPANY RIVIERA 2008” sh.p.k**, me adresë Kamëz, Rruga Nacionale Kamëz-Fushë Kruje, Kthesa e Valiasit Nr.1; 1030, me NIPT K81716011V dhe administrator z.Agim Kola.
- **Vlera e ofertës ekonomike**= 72 257 364 (shtatëdhjetë e dy milion dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa t.v.sh .

Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik **“COMPANY RIVIERA 2008”sh.p.k**, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se:

-Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3-4-**Personeli mbeshtetes i kualifikuar dhe teknik**

2.3.4- a)-Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) punonjës manovratorë të mjeteve/makinerive të rënda specifiku sipas profileve të mëposhtme:

- Manovrator eskavatori→**1 manovrator**
- Manovrator (Rruli vibrues/ rrul asfalti) →**1 manovrator**
- Manovrator (Autobitumatriçe/autovinc) →**1 manovrator.**
- Manovrator Grejderi →**1 manovrator.**
- Manovrator Asfalto-shtruese→**1 manovrator**

Për cdo profil punonjësi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës) si dhe dëshmia e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda (të vlefshme), lëshuar nga institucionet kompetente përkatëse sipas modaliteteve të **urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019.**

Referuar **urdhrit nr. 200, datë 16.05.2019 të MIE** “Për Miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënjen e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit” **neni nr.8** , makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmisë së Aftësisë Profesionale (DAP) të cilat ndahen si më poshtë:

1. **Manovrator me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP) Eskavatorist-** eskavator gjurmimi e ngarkimi dherash, të gjitha llojet si dhe fadromat të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë).
2. **Manovrator Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP) Buldozierist** – buldozier gjurmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: të gjithë llojet e traktoreve me thike (ruspe) ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperet, grejderet dhe niveluesit kur janë vetelevizet, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj.
3. **Manovrator Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP) Automakinist** – Automjete për përdorim të vecantë (APV), makineri ndërtimi mbi bazë automjeti-autovinca, autobetonjere, autopompa betoni, autobitumatriçe , autosonda, autotokmak.

Sipas urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019, neni 8 dhe kërkesa e DST-së pika 2.3.4- a)-kërkohen specifiku manovratorët si më poshtë:

- **1(një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për Eskavatorist** (Manovrator eskavatori)
- **3(tre)manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist**(1 Manovrator asfaltoshtruese; 1 Manovrator grejderi; 1 Manovrator rruli vibrues/rrul asfalti);
- **1(një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për Automakinist**(Manovrator Autobitumatriçe/Autovinçi)

Operatori ekonomik “**COMPANY RIVIERA 2008**”sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin provues për 5(pesë) **punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerive të rënda sipas dëshmime të aftësisë profesionale si më poshtë:

- 1(një) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Eskavatorist**
- 1(një) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist**
- 3(tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Automakinist**

Gjithashtu, certifikatat e trajnimit të paraqitura nuk përbëjnë dëshmi të aftësisë profesionale (DAP) të kërkuar në dokumentet e procedurës.

Operatori ekonomik “**COMPANY RIVIERA 2008**”sh.p.k, megjithëse ka paraqitur numrin minimal të manovratorëve, nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.4 (a) të DST-së, pasi nuk ka paraqitur profilet e kërkuara. Konkretisht, në DST kërkohej 3(tre) manovrator Buldozierist dhe operatori ekonomik ka paraqitur 1(një) manovrator Buldozierist. Profili i Automakinistit nuk mund të konsiderohet si Buldozierist për qëllim përmbushjen e këtij kriteri specifik.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk ka provuar disponueshmërinë e numrit të kërkuar të manovratorëve sipas profileve të përcaktuara në DST, për manovrator Buldozierist.

-Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3.5 të Dokumentave Standarde të Tenderit, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës , nënpika 1 -** *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi duhet të paraqitet a)dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit në pronesi leja e qarkullimit(e vlefshme) - b)çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme); c)siguracionin e detyrueshem të mjetit sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (i vlefshëm); d) Çertifikatë transporti mallrash sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (e vlefshme) , Ndërsa për mjete të marra me qira/perdorim krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet/n edhe kontrata/t përkatëse të qerasë/marrjes në përdorim e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.*

Për mjetin **Grejder** , të marrë me qira me subjektin” Ndërtimi ing”sh.p.k me nr. rep.4743 datë 08.11.2023, nuk disponohet dokumentacioni tekniko-ligjor i nevojshëm *a)dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit në pronesi leja e qarkullimit(e vlefshme) - b)çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme); c)siguracionin e detyrueshem të mjetit sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (i vlefshëm);* pasi Grejder është mjet i cili duhet të ketë dokumentacionin ligjor të qarkullimit.Operatori ekonomik ka paraqitur vetëm deklaratë doganore me nr.R 12322 datë 06.06.2022.

Për rrjedhojë, në mungesë të dokumentacionit për mjetin Grejder, kërkesa e kriterit **2.3.5 nënpika 1** nuk konsiderohet e plotësuar.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion e vlefshëm sipas kërkesave të nenit 82.5 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- “**K.M.K**” sh.p.k, me adresë Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090 1057 me NIPT L78223801E dhe administrator z. Kelmend Caushaj dhe subjekt mbështetës “**Caushi M**” sh.p.k Fier Ballsh BALLSH Ballsh-Mallakastër, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati I-re, Zona Kadastrale 1090, Nr Pasurie 7/9810 me NIPT L88419801O, me administrator z. Mehmet Caushaj.

- **Vlera e ofertës ekonomike**=78 983 284(shtqtdhjetë e tetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër)lekë pa t.v.sh.

(Memorie elektronike 143MB)

Sipas procesverbalit nr.5661/1 datë 13.07.2026, përkatësisht për arsyet si vijon :

Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik “K.M.K” sh.p.k dhe subjektit mbështetës “Caushi M” sh.p.k, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se:

-Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3.5 të Dokumentave Standarde të Tenderit, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës , nënpika 1 -** *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi duhet të paraqitet a)dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit ne pronesi leja e qarkullimit(e vlefshme) - b)çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme); c)siguracionin e detyrueshem te mjetit sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi (i vlefshëm); d) Çertifikatë transporti mallrash sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi (e vlefshme) , Ndersa per mjete te marra me qira/perdorim krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet/n edhe kontrata/t përkatëse te qerasë/marrjes ne perdorim e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.*

Për mjetin **Grejder** , të marrë me qira me subjektin “FEBA”sh.p.k me nr. rep.3421 datë 04.07.2025, nuk disponohet dokumentacioni tekniko-ligjor i nevojshëm *a)dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit ne pronesi leja e qarkullimit(e vlefshme) - b)çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme); c)siguracionin e detyrueshem te mjetit sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi (i vlefshëm);* pasi Grejder është mjet i cili duhet të ketë dokumentacionin ligjor të qarkullimit.

Operatori ekonomik ka paraqitur vetëm deklaratë doganore me nr.R 19909 datë 19.03.2009. Për rrjedhojë, në mungesë të dokumentacionit për mjetin Grejder, kërkesa e kriterit **2.3.5 nënpika 1** nuk konsiderohet e plotësuar.

Për mjetin **Autobot Uji**, me targë AJR181, të marrë me qira me Person fizik Bledar Ismaili, me kontratë qiraje nr.rep. 6265 datë 10.12.2025 rezulton se nuk është paraqitur *d) Çertifikatë transporti mallrash sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi (e vlefshme).*

Për rrjedhojë, në mungesë të certifikates se transportit për mjetin Autobot Uji, kërkesa e kriterit **2.3.5 nënpika 1 (d)** nuk konsiderohet e plotësuar.

Për mjetin **Makineri për skarifikim asfalti** dhe pajisje kokore për punonjësit Operatori ekonomik “K.M.K” sh.p.k është mbështetur në kapacitetet e subjektit “Caushi M” sh.p.k, të cilat subjekti “Caushi M” sh.p.k i ka marrë me kontratë qiraje nr.rep.1707 datë 29.04.2022 me shoqërinë “CAUSHI” sh.p.k.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe kontratës nr.rep.1707 datë 29.04.2022 rezulton se në pikën 3 të kushteve të saj ndërmjet subjektit mbështetës “Caushi M” sh.p.k dhe “CAUSHI” sh.p.k, është parashikuar shprehimisht se: ***“Qiramarrësi nuk mund t’ua jap me qira personave të tretë pajisjet e mësipërme.***

Në këto kushte, operatori mbështetës “Caushi M” sh.p.k nuk provon se gëzon të drejtën kontraktore për ta vënë këtë mjet në dispozicion të operatorit ekonomik ofertues, pasi vetë kontrata mbi bazën e së cilës ai e disponon mjetin kufizon transferimin e përdorimit të tij në

favor të personave të tretë. Për rrjedhojë, angazhimi për mbështetje nuk garanton disponueshmërinë ligjore të mjetit gjatë ekzekutimit të kontratës publike.

Për sa më sipër, KVO vlerëson se operatori ekonomik nuk ka provuar përmbushjen e kriterit të kualifikimit që lidhet me disponueshmërinë e mjetit të kërkuar në DST, pasi mbështetja në kapacitetet e operatorit “Caushi M” sh.p.k nuk mbështetet në një të drejtë të vlefshme kontraktore për vënien në dispozicion të këtij mjeti.

Për rrjedhojë, në mungesë të provues së disponueshmërisë ligjore të këtij mjeti, kërkesa e kriterit **2.3.5** nuk konsiderohet e plotësuar. dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

-Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3.3 Personeli dhe fuqia punetore:**

a)-Kandidati/ofertuesi/ Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën **31 (tridhjetë e një) punonjesve** duke përfshirë personelin teknik , drejtuesit teknik si dhe mbeshtetes , për periudhen e 3 (tre) muajve të fundit te deklaramit tatimor ,duke nisur nga data e hapjes së ofertave/shprehjes se interest te provuar , si më poshtë:

- Vertetim te leshuar administrate tatimore kompetente sipas legjislacionit fiskal ne fuqi ku te specifikohet nr. total i punonjesve per te cilet derdhet kontribut sigurimi shoqeror/shendetesor sipas legjislacionit ne fuqi .

Ose

- Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 025) sipas formatit elektronik ne perputhje me VKM nr 922 date 29.12.2014’’**Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike’’.**

-Si dhe sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3-4-Personeli mbeshtetes i kualifikuar dhe teknik**

2.3.4- a)-Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **5 (pese) punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerive të rënda specifikisht sipas profileve te meposhtme:

- Manovrator eskavatori→**1 manovrator**
- Manovrator (Rruli vibrues/ rrul asfalti) →**1 manovrator**
- Manovrator (Autobitumatriçe/autovinc) →**1 manovrator.**
- Manovrator Grejderi →**1 manovrator.**
- Manovrator Asfalto-shtruese→**1 manovrator**

Për cdo profil punonjesi teknik si me siper duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates) si dhe dëshmia e aftësisë profesionale per perdoruesit e makinerive te renda (të vlefshme), lëshuar nga institucionet kompetente perkatese sipas modaliteteve te **urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019**

2.3.4-b)-Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë shofere/drejtues mjeti gjithsej **05(pese) punonjes te drejtimit te automjeteve** te profileve te meposhtme:

- Shoferë kamioni→**2 shoferë,**
- Shoferë kamioncine→**1 shofer**
- Shoferë autoboti→**1 shofer**
- Shoferë kamioni me vinç→**1 shofer**

Per cdo profil te shofereve te mesiperm nga ana e operatorit ekonomik pjesemarrës duhet te paraqitet si prova apo deshmi te disponimit te tyre dokumentacioni i meposhtem:

- Kontrata individuale punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates).
- Leja e Drejtimit per kategorine perkatese sipas kerkesave te rregulloreve ne fuqi te miratuara nga autoritetet kompetent publike (e vlefshme).
- Dëshmite e aftesise profesionale ose Certificate te Aftesise Profesionale(CAP)(të vlefshme),lëshuar nga institucionet perkatese/autoritetet kompetente sipas rregullave te qarkullimit rrugor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise sipas kategorise respektive te mjetit

Operatori ekonomik “K.M.K” sh.p.k, ka paraqitur kontrata pune për 10 manovratorë dhe shoferë, përkatësisht për : Arben Vreto, Pashk Deda, Azem Shega, Alban Tafa, Ilir Caushi, Eshtref Shahini, Leonard Shahini, Fatjon Spahiu, Gentian Spahiu, Fation Aliu.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe përmbajtja e këtyre kontratave , sipas pikës 2 të kontratave për secilin punonjës përcaktohet se: **Kontrata lidhet me 6 (gjashtë) muaj , i cili fillon nga data e fillimit të punimeve në rast realizimi të objektit të prithëm “Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Fushë-Krujë faza I”.**

Në pikën 2.3.4 të Dokumenteve Standarde të Tenderit është përcaktuar shprehimisht se për çdo profil punonjësi teknik duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (përgjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës). Kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik nuk provojnë ekzistencën e një marrëdhënieje pune të vlefshme në momentin e paraqitjes së ofertës, pasi hyrja në fuqi e tyre është kushtëzuar nga fillimi i punimeve të objektit. Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk provon disponueshmërinë e personelit të kërkuar sipas DST-së.

Dokumentacioni i paraqitur konsiston në kontrata pune të lidhura ditën e hapjes së procedurës cilat nuk provojnë disponueshmërinë e një marrëdhënie pune aktuale, pasi hyrja në fuqi e këtyre kontratave është e kushtëzuar nga shpallja fitues e operatorit ekonomik dhe fillimit të punimeve. Punonjësit e deklaruar nuk rezultojnë të jenë në marrëdhënie pune të vlefshme me operatorin ekonomik në momentin e paraqitjes së ofertës.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk provon përmbushjen e kërkesave të pikave 2.3.3 dhe 2.3.4 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, në kuptim të nenit 82 të ligjit nr. 162/2020 ‘Për Prokurimin Publik’ dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

.

- ❖ Nderkohe qe kualifikohen per plotesim te kriterëve te pergjithshme dhe te vecanta keto operatore ekonomike te rendituar sipas kriterit percaktues te ofertes fituese cmimi me ulet, operatorët ekonomik si vijon:

1. **B.O.E “MAKARESH” sh.p.k**, me adresë Durrës Fushë- Krujë , Lagjja Grumbullimit, rruga e Laçit, pallati i ri, kati 1, zona kadastrale nr. 1664, me numër pasurie 3/426, me NIPT C24725213C, me administrator Z.Qamil Babasi përqindja në pjesëmarrje Loti I 9.2% dhe Loti II 12% dhe **“LIQENI VII” sh.p.k** me adresë Lagja 14 Rruga “Dituria”, Shkozë, Durres, 2007 me NIPT K01730502W dhe administrator z. Musa Kalia, përqindja në pjesëmarrje Loti I 90.8% dhe Loti II 88%, perfaqesues i BOE subjekti **“MAKARESH” sh.p.k**.

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 79 405 121 (shtatëdhjetë e nëntë milion e katërqind e pesë mijë e njëzet e një) lekë pa t.v.sh.

2. **“PE - VLA - KU” sh.p.k**, me adresë Rr.Muzakët, pallati Vokshi k.7 1001 Tiranë , me NIPT K61716013M dhe administrator z.Vladimir Pjetërgjokaj me subjekt mbështetës **“PE - VLA - KU” sh.p.k** dega Kosovë, me adrese Rr. Tringe Smajli, 16/7 Prishtinë me administrator z.Vladimir Pjetërgjokaj.

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 84 612 254.60 (tetëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë) lekë pa t.v.sh.

3. **“K.TURJA” sh.p.k**, me adresë pranë Urës së Gjolës, Bubq Budull 1505 me NIPT K81314014A dhe administrator z.Genci Truja dhe subjekt mbështetës **“Almo Konstruksion” sh.p.k** , me adresë Zall-Mner i ri, rruga nacionale Kamëz, Tiranë, me NIPT J91915001P dhe administrator z.Alfons Bitri perfaqesues i BOE subjekti **“K.TURJA” sh.p.k**.

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 85 272 258 (tetëdhjetë e pesë milion e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa t.v.sh .

4. **“Shendelli” sh.p.k**, me adresë Lagjja "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat Fier 9301, me NIPT K07924803N dhe me administrator z.Yzedin Bozhaj.

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 85 352 907 (tetëdhjetë e pesë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatë) lekë pa t.v.sh.

5. **“NDREGJONI” sh.p.k**, me adresë Tirane , Njesia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega , ndertesa nr. 32, hyrja 8 kodi postar 1017, me NIPT K31329048I dhe me administrator z.Xhetan Ndrejoni.

- **Vlera e ofertës ekonomike**= 86 772 659 (tetëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa t.v.sh.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **[B.O.E “MAKARESH” sh.p.k,** me adresë Durrës Fushë- Krujë , Lagjja Grumbullimit, rruga e Laçit, pallat i ri, kati 1, zona kadastrale nr. 1664, me numër pasurie 3/426, me NIPT K24725213C, me administrator Z.Qamil Babasi përqindja në pjesëmarrje 10.6% dhe **“LIQENI VII” sh.p.k** , me adresë Lagja 14 Rruga “Dituria”,Shkozë, Durres, 2007 me NIPT K01730502W dhe administrator z. Musa Kalia, përqindja në pjesëmarrje 89.4% me subjekt perfaqesues **“MAKARESH” sh.p.k**] se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [79 405 121 (shtatëdhjetë e nëntë milion e katërqind e pesë mijë e njëqind njëzet e një) lekë pa t.v.sh.]/pikët totale të marra *[NUK KA VLERESIMI ME PIKE]* Jështë identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[BASHKIA KRUJE , QENDER SHESHI MUSTAFA MERLIKA(KRUJA)]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 05(PESE) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [84 612 254.60 (tetëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë) lekë pa t.v.sh.] siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr.____ Datë____ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Artur BUSHI

Konceptoi:G.Halili